

VENDIM
Nr. 1056, datë 23.12.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR SIGURINË E ASHENSORËVE NË PËRDORIM”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 16, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e ashensorëve në përdorim”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULL TEKNIK
PËR SIGURINË E ASHENSORËVE NË PËRDORIM

1. Fusha e zbatimit

Ky Rregull Teknik zbatohet për të gjithë ashensorët ekzistues (që janë në përdorim) dhe për ashensorët e rinj, të cilët instalohen në ndërtesa në bashkëpronësi, në ambiente shtëpiake ose në vendin e punës, përfshirë edhe komponentët e tyre të sigurisë me qëllim për të garantuar sigurinë gjatë gjithë periudhës së përdorimit të tyre.

2. Përkufizime

Në këtë Rregull Teknik termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

2.1 “Struktura Përgjegjëse” është struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut nën minis-trinë përgjegjëse për tregtinë.

2.2 “Certifikatë regjistrimi” është certifikata e lëshuar nga struktura përgjegjëse lidhur me regjistrimin e një ashensori në zbatim të pikës 4 të këtij Rregulli Teknik.

Kërkesa për regjistrim bëhet nga personi përgjegjës, si referohet në pikën 24, të nenit 3, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar.

2.4 “Ashensor ekzistues” është ashensori i instaluar dhe i vendosur në shërbim përpara datës 31 dhjetor 2009.

2.5 “Ashensor i ri” është ashensori i instaluar dhe i vendosur në shërbim duke filluar që prej datës 1 janar 2010.

2.6 “Modifikim i rëndësishëm” është çdo ndryshim/modifikim në ashensor, i cili mund të rrezikojë sigurinë e tij dhe minimalisht përfshin:

2.6.1 Për ashensorët ekzistues dhe të rinj të tipit elektrik,

a) ndryshimi i:

i) shpejtësisë nominale;

ii) ngarkesës nominale;

iii) masës së kabinës;

iv) korsës lëvizëse (lartësisë);

b) ndryshimi ose zëvendësimi i:

i) tipit të pajisjes për mbylljen e dymve në sheshpushim (zëvendësimi me të të njëjtit tip nuk konsiderohet modifikim i rëndësishëm);

ii) sistemit të kontrollit;

iii) shinave udhëzuese ose i tipit të shinave udhëzuese;

iv) tipit të derës (ose shtimi i një ose më shumë sheshpushimeve ose i dymve në kabinë);

v) agregatit ose sistemit tërheqës;

vi) kufizuesit të mbishpejtësisë;

vii) mjeteve mbrojtëse të lidhura me mbi-shpejtësinë e kabinës gjatë ngritjes;

viii) amortizatorëve;

ix) mekanizmit mekanik të sigurisë.

2.6.2 Për ashensorët ekzistues dhe të rinj të tipit hidraulik,

a) ndryshimi i:

i) shpejtësisë nominale;

ii) ngarkesës nominale;

iii) masës së kabinës;

iv) korsës lëvizëse (lartësisë);

b) ndryshimi ose zëvendësimi i:

i) tipit të pajisjeve për mbylljen e dyerve në sheshpushim (zëvendësimi me një pajisje të të njëjtit tip nuk konsiderohet modifikim i rëndësishëm);

ii) sistemit të kontrollit;

iii) shinave udhëzuese ose i tipit të shinave udhëzuese;

iv) tipit të derës (ose shtimi i një ose më shumë sheshpushimeve ose i dyerve në kabinë);

v) agregatit lëvizës;

vi) kufizuesit të mbi-shpejtësisë;

vii) amortizatorëve;

viii) mekanizmit mekanik të sigurisë;

ix) pajisjes shtrënguese;

x) pajisjes bllokuese;

xi) krikut;

xii) valvulës së shkarkimit të presionit;

xiii) valvulës/valvuleve të stakimit;

xiv) kufizuesit/kufizues me një drejtim.

2.7 “Instalues i një ashensori” është personi juridik që merr përgjegjësinë për projektimin, prodhimin, instalimin dhe vendosjen në treg të ashensorit.

2.8 “Modernizim” është çdo modifikim në ashensor që synon të përmirësojë shkallën e sigurisë.

2.9 “Inspektim periodik” është inspektimi që minimalisht përfshin të gjitha kontrollet e shprehura në pikën 13 të këtij Rregulli Teknik dhe është i parashikuar për të:

a) kontrolluar funksionimin e përshtatshëm të karakteristikave të sigurisë të ashensorit; dhe

b) zbuluar çdo defekt që mund të shfaqet / ndodhë gjatë përdorimit ose keq-përdorimit të ashensorit.

2.10 “Mirëmbajtje” është tërësia e proceseve /veprimeve të nevojshme për të shmangur dhe eliminuar parregullsitë e mundshme në ashensor, përfshirë komponentët e tij me qëllim për të garantuar sigurinë dhe funksionimin e parashikuar të ashensorit, përgjatë gjithë ciklit të jetëgjatësisë së përdorimit të tij.

2.11 “Organizëm kompetent” është një person juridik apo pjesë e tij, ku personat teknikisht të kualifikuar kryejnë përkatësisht veprimet e modernizimit/modifikimit ose/dhe mirëmbajtjes.

2.12 “Person teknikisht i kualifikuar” është çdo person me trajnimin e përshtatshëm teoriko-praktik dhe me eksperiencë të mjaftueshme për të kryer çdo modernizim/modifikim ose/dhe riparim të ashensorit, përkatësisht të dokumen-tuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse”. Deri në krijimin e organeve certifikues të personelit, detyrat e këtij organi do të kryhen nga një komision i miratuar nga ministri përgjegjës për tregtinë, anëtarët e të cilit duhet të jenë inxhinierë mekanikë, elektrikë dhe elektronikë me eksperiencë përkatëse të dokumentuar në fushën e ashensorëve.

2.13 “Vendosje në shërbim” është bërja e disponueshme për herë të parë e ashensorit përfshirë edhe komponentët e tij të sigurisë për të gjithë përdoruesit e tij.

2.14 “Analizë risku” është ekzaminimi i aspekteve të sigurisë, të referuara në pikën 11 të këtij Rregulli Teknik, me qëllim që të përcaktohet nëse janë zbatuar mjaftueshmërisht masat parandaluese lidhur me risqet në fjalë.

2.15 “Ekzaminim i plotë” është kontrolli sistematik dhe i detajuar i ashensorit nga një organ i miratuar, me qëllim përmirësimin e sigurisë së ashensorit në nivel të pranueshëm, identifikimin e risqeve serioze që mund të kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, si dhe identifikimin e përmirësimeve të ashensorit që rrisin shkallën e tij të sigurisë.

2.16 “Vend pune” është çdo ndërtesë, vend, objekt ose vendndodhje, qoftë publik ose privat, në të cilin punëmarrësit kanë të drejtë të përdorin/të hyjnë për qëllime pune dhe që janë nën kontrollin e

drejtpërdrejtë ose të tërthortë të punëdhënësit.

Të gjithë termat e tjerë, të përdorur në këtë Rregull Teknik, kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuara në ligjin nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar, dhe legjislacionin për ashensorët.

3. Kërkesa të përgjithshme

3.1 Personi përgjegjës siguron që ashensori është i markuar qartësisht dhe në mënyrë të paheqshme me të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin dhe adresën e instaluesit (nëse nuk ekziston pronari i ndërtesës);
- b) markimin CE (për ashensorët e rinj);
- c) emërtimin e serive ose tipin;
- d) numrin serial (nëse ka);
- e) vitin e instalimit;
- f) të dhënat e personit që duhet kontaktuar në rast të një problemi.

3.2 Personi përgjegjës për ashensorin siguron që në çdo kabinë është vendosur një pllaketë lehtësisht e dukshme me përshkrimet e mëposhtme:

- a) ngarkesa nominale në kg;
- b) numri maksimal i njerëzve që mund të transportohen;
- c) data e inspektimit periodik parandalues të fundit dhe e organit të miratuar përkatës, përfshirë numrin e tij të identifikimit;
- d) data e inspektimit periodik parandalues të ardhshëm; dhe
- e) çdo instruksion tjetër përkatës sipas përcaktimit në rregullin teknik për ashensorët.

3.3 Çdo ashensor i ri kur vendoset në treg/shërbim shoqërohet nga dokumentacioni përkatës siç përcaktohet në legjislacionin e veçantë për ashensorët.

3.4 Personi përgjegjës/instaluesi i ashensorit siguron listën e të gjithë komponentëve të sigurisë të përfshirë në ashensor.

3.5 Personi përgjegjës vë në dispozicion të organit të miratuar dokumentacionin e referuar në nënpikën 3.3.

3.6 Organi i miratuar regjistrohet në ministrinë përgjegjëse për tregtinë sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr. 10489/2011.

3.7 Një organ i miratuar nuk mund të kryejë inspektime në ashensorë që janë në pronësi / bashkëpronësi të tij.

4. Aplikimi për regjistrim

4.1 Çdo ashensor i ri ose ekzistues regjistrohet pranë Strukturës Përgjegjëse, siç referohet në nenin 16 të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar. Personi përgjegjës që bën regjistrimin e një ashensori të ri duhet gjithashtu të bashkëngjisë në formatin e regjistrimit dhe një kopje të deklaratës së konformitetit të ashensorit dhe të komponentëve të tij të sigurisë.

4.2 Formatin e regjistrimit për ashensorët ekzistues dhe të rinj përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) datën e aplikimit;
- b) treguesin nëse është aplikimi i parë apo një aplikim për një ashensor tjetër dhe nëse po, të specifikohet numri total i ashensorëve të regjistruar aktualisht;
- c) treguesin në lidhje me përdorimit të ashensorit në një ndërtesë në bashkëpronësi, në ambient shtëpiak ose në vendin e punës;
- d) emrin e plotë të instaluesit/personit përgjegjës;
- e) emrin dhe adresën e ndërtesës;
- f) natyrën e përdorimit primar/kryesor të ndërtesës;
- g) detaje të kontaktit për instaluesin/ personin përgjegjës;
- h) të dhëna mbi karakteristikat e ashensorit në lidhje me tipin e ashensorit, natyrën e përdorimit, klasifikimin e përdorur, të dhëna mbi prodhuesin dhe instaluesin, numrin e regjistrimit të kompanisë, datën e instalimit, kapacitetin, shpejtësinë, numrin e ndalimeve dhe hyrjet e personave me aftësi të kufizuara;
- i) të dhëna mbi organet përgjegjëse të vlerësimit të konformitetit; dhe
- j) firmën e instaluesit/personit përgjegjës.

4.3 Informacioni i referuar në nënpikën 4.2 të këtij Rregulli Teknik dërgohet pranë Strukturës Përgjegjëse duke përdorur formatin e miratuar nga kryeinspektori i Strukturës Përgjegjëse.

4.4 Struktura përgjegjëse lëshon certifikatën e regjistrimit mbas përfundimit me sukses të procedurës së regjistrimit.

4.5 Certifikata e regjistrimit duhet të ketë numrin unik të regjistrimit të përcaktuar nga struktura përgjegjëse.

5. Ekzaminimi i plotë i ashensorëve ekzistues dhe të rinj

5.1 Personi përgjegjës siguron se ashensori i nënshtrohet një ekzaminimi të plotë nga një organ i miratuar për këtë qëllim.

Organi i miratuar përzgjidhet nga personi përgjegjës sipas listës së publikuar më parë në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për tregtinë.

5.2 Ekzaminimi i parë i plotë i një ashensori ekzistues kryhet në zbatim të programit kohor të specifikuar në nënpikën 11.1 të këtij Rregulli Teknik.

5.3 Ekzaminimi i plotë për ashensorët përfshin një analizë risku, e cila minimalisht merr parasysh aspektet e sigurisë të listuara në pikën 11 në këtë Rregull Teknik.

a) Çdo analizë risku merr parasysh kushtet specifike të përdorimit të ashensorit që lidhen me përdoruesit e ashensorit, veçanërisht kur përdoruesit janë me aftësi të kufizuara.

b) Kur është rasti, analiza e riskut merr parasysh dhe vlerën historike/vjetërsinë e ndërtesës në të cilën ashensori është instaluar.

5.4 Të gjithë ashensorët e rinj të vendosur në shërbim me markimin CE, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10489/2011 dhe legjislacionin e veçantë për ashensorët, prezumohen se i janë nënshtrohet ekzaminimit të parë të plotë.

5.5 Mbas ekzaminimit të parë të plotë të ashensorit, personi përgjegjës siguron që:

a) ekzaminimet e plota pasuese kryhen brenda një periudhe 6-mujore nga data e kalimit të afatit të ekzaminimit pasardhës të deklaruar në raportin e ekzaminimit paraardhës;

b) periudha ndërmjet dy ekzaminimeve të plota për ashensorët e instaluar në një vend pune nuk duhet të kalojë 6 vjet;

c) periudha ndërmjet dy ekzaminimeve të plota për ashensorët e instaluar në ndërtesa në bashkëpronësi ose në ambiente shtëpiake nuk duhet të kalojë 10 vjet;

d) ashensori u nënshtrohet inspektimeve periodike, ndërmjet ekzaminimeve të plota të njëpasnjëshme, nga një organ i miratuar në intervale kohore, si janë përcaktuar në pikën 7 të këtij Rregulli Teknik;

e) një ekzaminim i plotë kryhet në çdo rast kur ndodh një aksident, një modifikim i rëndësishëm ose në rrethana ekstreme të cilat mund të rrezikojnë sigurinë e ashensorit.

5.6 Personi përgjegjës mban në dispozicion të organit të miratuar çdo informacion lidhur me funksionin dhe përdorimin e ashensorit përkatës.

5.7 Organi i miratuar, kur konstaton një risk të mbartur ose një risk të pashmangshëm për dëmtime të rënda të personit, i kërkon personit përgjegjës ndalimin e përdorimit të ashensorit, riparimin ose mirëmbajtjen e menjëhershme të tij.

Organi i miratuar informon me shkrim ministrinë përgjegjëse për tregtinë), Strukturën Përgjegjëse dhe sipas rastit edhe organet e rendit, maksimalisht brenda 2 ditë pune nga data e kryerjes së këtij inspektimi.

6. Modernizimi i ashensorit

6.1 Ashensori ekzistues, pas ekzaminimit të plotë nga një organ i miratuar për këtë qëllim, duhet të përmirësojë nivelin e sigurisë sipas përcaktimeve/rekomandimeve në raportin e hartuar nga ky organ.

6.2 Organi i miratuar përcakton, mbi bazën e analizës së riskut të kryer gjatë ekzaminimit të plotë, risqet serioze që kërkojnë një vëmendje të menjëhershme ose/dhe ato që kërkojnë veprime modernizimi sipas një skeduli kohor.

6.3 Organizmi kompetent për modernizimin e ashensorëve (me personat teknikisht të kualifikuar), i përzgjedhur nga personi përgjegjës, kryen veprimet e modernizimit/përmirësimit/korri-gjimet e ashensorit sipas rekomandimeve nga organi i miratuar.

Personi përgjegjës përballon shpenzimet e përfshira në këtë modernizim.

6.4 Mbas përfundimit të veprimeve të modernizimit, personi përgjegjës informon organin e miratuar që ka kryer ekzaminimin e plotë. Ky organ kontrollon modifikimet e bëra dhe lëshon një certifikatë miratimi nëse verifikon se ato janë kryer të gjitha korrektësisht dhe në përputhje me përcaktimet nga organi i miratuar.

Organi i miratuar dërgon brenda 15 ditëve një kopje të kësaj certifikatë në ministrinë përgjegjëse për tregtinë dhe Strukturën Përgjegjëse.

7. Inspektimi periodik i ashensorëve ekzistues dhe të rinj

7.1 Personi përgjegjës paraqet pranë një organi të miratuar një kërkesë për një inspektim periodik, si për ashensorët ekzistues ashtu dhe për ato të rinj.

7.2 Personi përgjegjës njofton organin e miratuar për të kryer inspektimin periodik në ashensor sipas

intervaleve kohore që janë të specifikuara në nënpikat 7.4 dhe 7.5.

7.3 Organi i miratuar përzgjidhet nga personi përgjegjës sipas listës së publikuar më parë në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për tregtinë.

7.4 Në rastin e ashensorëve ekzistues dhe të rinj të instaluar në një vend pune, inspektimet periodike kryhen një herë në çdo 6 muaj, duke respektuar datën e parë të vendosjes së tyre në shërbim.

7.5 Në rastin e ashensorëve ekzistues dhe të rinj të instaluar në ndërtesa në bashkëpronësi ose në ambiente shtëpiake, inspektimet periodike kryhen një herë në çdo 12 muaj, duke respektuar datën e parë të vendosjes së tyre në shërbim.

7.6 Organi i miratuar kryen inspektimet periodike duke u bazuar në listën e kontrollit të hartuar në ekzaminimin e fundit të plotë dhe duke pasur parasysh listën e kontrolleve minimale të dhëna në pikën 13 të këtij Rregulli Teknik.

7.7 Lista e kontrollit e inspektimit periodik i bashkëngjitet raportit të ekzaminimit të plotë të referuar në pikën 12 të këtij Rregulli Teknik.

7.8 Kur inspektimi periodik i radhës nuk kalon suksesshëm për shkak të një risku të rëndë të ashensorit ose një moszbatimi të veprimeve të modernizimit të dhëna në pikën 6 të këtij Rregulli Teknik, organi i miratuar përcakton një afat kohor brenda të cilit duhet të realizohen riparimet / modifikimet e kërkuara.

7.9 Në përfundim të veprimeve, referuar në pikën 7.8, të kryera nga një organizëm kompetent për riparime/mirëmbajtje (me personat teknikisht të kualifikuar), personi përgjegjës njofton me shkrim organin e miratuar, i cili duhet të kontrollojë nëse këto riparime/modifikime janë kryer korrektësisht dhe ashensori mund të vazhdojë përdorimin e tij të sigurt. Në këtë rast, organi i miratuar bashkëlidh këtë informacion në raportin përfundimtar.

7.10 Organi i miratuar, kur konstaton se ashensori kërkon riparim ose mirëmbajtje të menjëhershme të tij, për shkak të një risku të mbartur ose një risku të pashmangshëm për dëmtime të rënda të personit, i kërkon personit përgjegjës ndalimin e përdorimit të ashensorit.

Organi i miratuar informon me shkrim ministrinë përgjegjëse për tregtinë strukturën përgjegjëse dhe, sipas rastit, organet e rendit maksimalisht brenda 2 ditë pune nga data e kryerjes së këtij inspektimi.

8. Raportet dhe defektet

8.1 Organi i miratuar që ka kryer një ekzaminim të plotë, sipas pikës 5 të këtij Rregulli Teknik, harton me shkrim raportin për ekzaminimin e plotë duke përfshirë të gjithë informacionin e specifikuar në pikën 12 të këtij Rregulli Teknik.

8.2 Organi i miratuar dërgon një kopje të këtij raporti te personi përgjegjës, ministrinë përgjegjëse për tregtinë dhe strukturën përgjegjëse jo më vonë se 28 ditë nga data në të cilën është kryer ekzaminimi i plotë.

8.3 Në zbatim të nënpikës 5.7, organi i miratuar harton raportin dhe dërgon atë te personi përgjegjës, ministrinë përgjegjëse për tregtinë dhe strukturën përgjegjëse brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të ministrisë dhe strukturës përgjegjëse, referuar në pikën 5.7.

Në këtë raport, organi i miratuar duhet të identifikojë risqet që mund të kërkojnë zëvendësimin e ashensorit ose risqe që kërkojnë ndalimin e përkohshëm të ashensorit deri në përfundimin e riparimeve dhe përmirësimeve përkatëse.

8.4 Çdo certifikatë testimi dhe/ose raporte të tjera i bashkëngjiten raportit të ekzaminimit të plotë.

8.5 Organi i miratuar, që ka kryer inspektimin periodik sipas pikës 7 të këtij Rregulli Teknik, harton me shkrim raportin mbi inspektimin periodik që përmban informacionin e specifikuar në pikën 14 të këtij Rregulli Teknik.

8.6 Organi i miratuar dërgon një kopje të këtij raporti te personi përgjegjës, në ministrinë përgjegjëse për tregtinë dhe strukturën përgjegjëse jo më vonë se 28 ditë nga data në të cilën është kryer inspektimi periodik.

8.7 Në zbatim të nënpikës 7.10 të këtij Rregulli Teknik, organi i miratuar harton dhe dërgon raportin te personi përgjegjës, në ministrinë përgjegjëse për tregtinë dhe strukturën përgjegjëse brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të ministrisë dhe strukturës përgjegjëse, referuar në nënpikën 7.10.

Në këtë raport, organi i miratuar duhet të identifikojë risqet që mund të kërkojnë zëvendësimin e ashensorit, ose risqe që kërkojnë ndalimin e përkohshëm të ashensorit deri në përfundimin e riparimeve dhe përmirësimeve përkatëse.

8.8 Çdo certifikatë testimi dhe/ose raporte të tjera i bashkëngjiten raportit të inspektimit periodik.

9. Regjistrimet

9.1 Personi përgjegjës siguron librin e sigurisë për çdo ashensor, ku përfshihen:

a) deklaratat EC të konformitetit për komponentët e sigurisë për ashensorë dhe ashensorit të instaluar;

b) manuali i instruksioneve për të gjithë komponentët e sigurisë së ashensorit, me qëllim që të kryhet me efektivitet dhe pa rrezik mirëmbajtja e duhur, si dhe të përdoret nga organi i miratuar gjatë

ekzaminimeve të plota dhe inspektimeve periodike të ashensorit;

c) dokumentacioni që përfshin manualin e instruksioneve i cili përmban planimetritë dhe diagramat e nevojshme për një përdorim normal të lidhur me mirëmbajtjen, inspektimin, riparimin dhe kontrollet periodike;

d) certifikatën e regjistrimit të ashensorit;

e) raportin e ekzaminimit të plotë; dhe

f) raportin i inspektimit periodik.

9.2 Personi përgjegjës mban librin e sigurisë në dispozicion të organit të miratuar, nëse shikohet e arsyeshme nga ky organ.

9.3 Personi përgjegjës siguron se raportet e hartuara nga organi i miratuar, raporte që lidhen me ekzaminimin e plotë dhe inspektimin periodik, mbahen të përditësuara në librin e sigurisë deri sa të hartohet raporti tjetër.

9.4 Të gjitha përmirësimet dhe riparimet që rezultojnë nga ekzaminimet e plota dhe mirëmbajtja, duke përfshirë datat kur janë kryer këto riparime apo mirëmbajtje, si dhe të dhënat mbi personat që kanë kryer këto riparime dhe mirëmbajtje, të shënohen në librin e sigurisë së ashensorit përkatës.

10 Mirëmbajtja e ashensorit

10.1 Për qëllime të ruajtjes së sigurisë së instalimit dhe mirëfunksionimit të tij, personi përgjegjës është i detyruar të sigurojë mirëmbajtje të ashensorit dhe të këtë një marrëveshje apo kontrate me një organizëm kompetent për mirëmbajtje.

10.2 Mirëmbajtja përfshin:

a) lubrifikime, pastrime etj.;

b) kontrolle;

c) proceset e shpëtimit të përdoruesve të ashensorit;

ç) proceset e konfigurimit dhe të rregullimit /ndreqjes;

d) riparimin ose ndryshimin e komponentëve të dëmtuar për shkak të përdorimit, të cilët nuk ndikojnë në karakteristikat e instalimit;

Veprimet e mëposhtme nuk konsiderohen si mirëmbajtje:

a) ndryshimi i komponentëve të rëndësishëm si kabina, motori, paneli i kontrollit etj., ose komponentët e sigurisë si mekanizmi i kontrollit, edhe kur karakteristikat e komponentit të ri janë të njëjtat me komponentin origjinal;

b) zëvendësimi i instalimit;

c) modernizimi i instalimit, përfshirë ndryshimin e ndonjë karakteristike të instalimit (të tilla si shpejtësia, kapaciteti i ngarkesës);

ç) proceset e shpëtimit të kryera nga organet e shpëtimit nga zjarri;

10.3 Çdo ashensor duhet të ketë udhëzimet për përdorim dhe mirëmbajtje, të cilave duhet t'u përmbahen gjatë mirëmbajtjes së rregullt të ashensorit dhe gjatë shpëtimit të personave në ashensor.

10.4 Kur në ashensorin ekzistues nuk ka udhëzime të nevojshme për përdorim, personi përgjegjës duhet t'i siguroj ato nga instaluesi i ashensorit ose sipërmarrësi i ndërtimit brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e këtij Rregulli Teknik.

Për udhëzime të tilla personi përgjegjës duhet të marrë pëlqim nga organi i miratuar.

10.5 Mirëmbajtja e ashensorit duhet të kryhet sipas nevojës, më së paku një herë në muaj për ndërtesat në bashkëpronësi apo ambientet e banimit dhe të paktën dy herë në muaj për ashensorët në vendet e punës.

10.6 Të mirëmbajtja duhet të mënjanohej të gjitha mangësitë në punën e ashensorit, kurse pjesët e parregullta dhe të dëmtuara të zëvendësohen me të rregullta.

10.7 Nëse gjatë mirëmbajtjes së ashensorit vërtetohen parregullsi të cilat mund të çojnë deri në gjendje të rrezikshme, organizmi kompetent për mirëmbajtjen (me personat teknikisht të kualifikuar) i kërkon personit përgjegjës të vendosë ashensorin jashtë përdorimit derisa ato të mënjanohej. Organizmi kompetent për mirëmbajtjen njofton menjëherë personin përgjegjës, ministrinë përgjegjëse për tregtinë dhe strukturën përgjegjëse, dhe në raste pa-zbatueshmërie edhe organet e rendit.

11. Format i ekzaminimit të plotë për ashensorët ekzistues dhe rreziqet minimale që merren parasysh gjatë analizës së riskut

11.1 Programimi kohor për kryerjen e ekzaminimeve të plota për ashensorët ekzistues.

Ekzaminimi i plotë i ashensorëve ekzistues, të vendosur në shërbim si është treguar në kolonën e parë të tabelës së mëposhtme, ka për t'u kryer jo më vonë se data e treguar në kolonën e dytë.

Deri më 31 dhjetor 2000	Jo më vonë se 31 dhjetor 2017
Nga 1 janari 2001 deri më 31 dhjetor 2009	Jo më vonë se 31 dhjetor 2018

11.2 Analiza e riskut

Analiza e riskut, si pjesë e ekzaminimit të plotë të ashensorit, bëhet në zbatim të pikës 5 të këtij Rregulli Teknik.

Masat e sigurisë të dhëna në këtë pikë zbatohen kur ekzistojnë probleme të lidhura me risqet.

11.3 Shtrirja e ekzaminimit të plotë dhe testet përkatëse të sigurisë

Ekzaminimi i plotë mbështetet në kërkesat thelbësore mbi shëndetin dhe sigurinë për projek-timin, prodhimin dhe instalimin e ashensorëve, si dhe të komponentëve përkatës të sigurisë, të dhëna në legjislacionin e veçantë për ashensorët, sipas shtrirjes së testimeve të mëposhtme:

- kërkesat e përgjithshme mbi materialet e përdorur;
- vlefshmëria e kërkesave;
- kërkesat ndaj vandalizmit;
- nëse kërkohet, sjellja e ashensorit ndaj rastit të zjarrit;
- kolona e ashensorit;
- agregati dhe vendet e pulexhos;
- dyert në sheshpushime dhe në kabinë;
- kabina;
- kundërpesha dhe pesha balancuese;
- varja, balancimi dhe mbrojtja nga mbi-shpejtësia;
- mbrojtja nga lëvizja e pakontrolluar e kabinës;
- udhëzuesit, amortizatorët dhe kufizuesit fundorë;
- distanca ndërmjet derës së kabinës dhe derës në sheshpushim;
- agregati lëvizës;
- mbrojtja për instalimet dhe pajisjet elektrike, kontrollet, prioritetet;
- shënimet, markimet dhe instruksionet e përdorimit.

11.4 Lista e standardeve të harmonizuara që kanë karakter referues për prezumimin e sigurisë të ashensorëve ekzistues dhe të rinj në përdorim jepet në pikën 15. Zbatimi i tyre ose i standardeve të njëjtlëshme me to, verifikohet nga organi i miratuar nëpërmjet inspektimeve përkatëse të sigurisë dhe tregohen në raportin e testimit, me vlerësimin e shprehur nëse testet përkatëse të sigurisë janë kryer plotësisht dhe nëse masat e listuara të riparimit janë të mjaftueshme për reduktimin e risqeve të vlerësuar.

12. Format i tip për raportin e ekzaminimit të plotë të ashensorit ekzistues dhe ashensori të ri

12.1 Seksioni A

a) Informacion për personin përgjegjës
emri dhe adresa e personit përgjegjës:

b) Informacion i lidhur me ashensorin:

☐ Ashensor ekzistues ☐ Ashensor i ri

Data e prodhimit:

☐ Ashensor në vendin e punës ☐ Ashensor në ndërtesë

Numri i regjistrimit:

Adresa ku është instaluar ashensori: _____

c) Ekzaminim i plotë

i) data e ekzaminimit të plotë të fundit _____

ii) Nëse ekzaminimi i plotë është:

☐ brenda një periudhe 6-mujore nga data e mbarimit të afatit kohor lidhur me ekzaminimin e plotë pasardhës

☐ brenda një periudhe 6-vjeçare ndërmjet ekzaminimeve të plota (për ashensorët ekzistues dhe të rinj të instaluar në vendin e punës)

☐ brenda një periudhe 10-vjeçare ndërmjet ekzaminimeve të plota (për ashensorët ekzistues dhe të rinj të instaluar në ambiente banimi)

iii) Është ekzaminimi i plotë si rezultat i një aksidenti, një modifikimi të rëndësishëm ose i një rrethane të jashtëzakonshme? Nëse po, jep informacion: _____

iv) Lista e komponentëve të sigurisë dhe pajisjeve mbrojtëse: _____

v) A janë komponentët e sigurisë dhe pajisjet mbrojtëse në gjendje të mirë pune? Jep

informacion: _____

vi) Rreziqet ekzistuese që kërkohet të evidentohen dhe nivelet prioritare: _____

vii) Rekomandime se si adresohen rreziqet: _____

viii) Afatet kohore (duke përfshirë datat) lidhur me masat korrigjuese, përmirësimet ose alternativat: _____

ix) A ka kushte të veçanta mbi përdorimin e ashensorit deri sa të realizohen punimet e nevojshme? _____

Data e ekzaminimit tjetër të plotë: _____

Bashkëngjit listën e kontrollit të inspektimit periodik.

12.2 Seksioni B

Ky seksion plotësohet vetëm në rastin e një risku të pashmangshëm me dëmtim të rëndë personi (në zbatim të nënpikës 5.7).

a) Përshkrimi i riskut ekzistues ose të pashmangshëm që mund të rezultojë me dëmtim të rëndë personi: _____

b) Riparimet ose modifikime të nevojshme: _____

c) Afatet kohore mbi kompletimin e punëve për të mundësuar përsëri përdorimin e ashensorit: _____

12.3 Seksioni C - Deklarimi

Unë/ne deklaroj se mbi..... unë/ne kam kryer një ekzaminim të plotë mbi këtë ashensor dhe që përfundimi është se raporti është në përputhje me rezultatin.

Organi i miratuar nr:

Adresa:

Firma/t:

Data

13. Kontrollët minimale të kryera gjatë një inspektimi periodik

13.1 Verifikimi i markimeve të detyruara dhe i dokumentacionit mbi:

a) emrin dhe adresën e instaluesit;

b) markimin CE (nëse kërkohet);

c) numrin e regjistrimit të instaluesit/personit përgjegjës;

d) numrit serial të ashensorit dhe vitin e prodhimit;

e) ngarkesën nominale _____ dhe numrin maksimal të pasagjerëve _____;

f) të dhënat e kontaktit të instaluesit/personit përgjegjës për të kontaktuar në rastin e një problemi;

g) të dhëna mbi personin juridik ose kompaninë e mirëmbajtjes;

h) çdo instruksion dhe dokumentacion përkatës.

13.2 Gjendja aktuale dhe funksionimi i pajisjeve mbrojtëse dhe i komponentëve të sigurisë:

a) çelësat fundorë;

b) pajisjet për mbylljen e dyerve në shesh-pushim;

c) pajisjet që sigurojnë se ashensori nuk operon nëse dyert janë të hapura në sheshpushim;

d) pajisja për parandalimin e lëvizjes së pakontrolluar gjatë ngritjes së kabinës;

e) pajisjet e kufizimit të mbishpejtësisë;

f) ndriçimi emergjent dhe ndriçimi i kabinës, kolonës së ashensorit, dhe vendit të agregatit;

g) amortizatorët;

h) butonat e sigurisë (si butoni i ndalimit emergjent në fundin e kolonës dhe në pjesën e sipërme të agregatit ose vendit të pullexhos).

13.3 Kushtet e përgjithshme dhe funksionimi i:

a) kabinës, kolonës dhe platformës së agregatit;

b) dyerve të kabinës dhe dyerve në shesh-pushim;

c) kavove metalike dhe kavos tërheqëse;

d) shinave udhëzuese;

e) sistemit të frenimit;

f) komponentëve të instalimit elektrik;

g) agregatit ngritës;

h) ventilimit (në kabinë, kolonën e ashensorit dhe në hapësirën e agregatit);

i) pajisjeve të kontrollit.

13.4 Inspektimi teknik i kabinës dhe kolonës së ashensorit:

- a) natyra dhe tipi i mureve të kolonës;
- b) kabina dhe veshjet e kabinës së bashku me kontrollin e përmasave;
- c) lidhja dhe varja e kabinës dhe kundërpesha;
- d) rrëshqitësit e kabinës dhe kundërpesha;
- e) kavot metalike, sistemi kremalier pinion, zinxhirët;
- f) burimet elektrike poshtë kabinës;
- g) kontrolli i dymve në sheshpushim, dymt e kabinës;
- h) pajisjet e bllokimit të derës dhe butonit të derës;
- i) dera e emergjencës;
- j) mekanizmi i kontrollit për inspektimin e tavanit të kabinës;
- k) sistemi komunikimit emergjent;
- l) pulexhot;
- m) tavani i kabinës;
- n) hapësira e kolonës;
- o) hapësira e lirë ndërmjet kabinës dhe kundërpesës dhe kolonës së ashensorit;
- p) kundërpesha.

14. Format i për hartimin e raportit të inspektimit periodik për një ashensor ekzistues dhe të ri
Seksioni A

a) Informacion mbi personin përgjegjës

Emri dhe adresa e personit përgjegjës _____

b) Informacion mbi ashensorin

☐ Ashensor ekzistues ☐ Ashensor i ri Data e prodhimit: _____

☐ Ashensor në vendin e punës ☐ Ashensor në ndërtesa

i) Numri i regjistrimit: _____

ii) Adresa e ndërtesës ku ashensori është instaluar: _____

iii) Ngarkesa e lejuar e punës: _____

iv) Shpejtësia e lejuar: _____

v) Numri i niveleve të ndalimit: _____

c) Inspektimi periodik

i) Data e inspektimit të fundit periodik _____

ii) Identifikimi dhe përshkrimi i çdo testimi të kryer: _____

Emërtimi	Përshkrimi i gjendjes aktuale	Përshkrimi i çdo riparimi ose mirëmbajtje të kryer
1. Emërtimi dhe funksionimi i pajisjeve mbrojtëse dhe komponentëve të sigurisë		
a) Çelësat fundorë		
b) Pajisjet për mbylljen e dymve në sheshpushim		
c) Pajisja për sigurimin se ashensori nuk funksionon nëse dymt në sheshpushim janë të hapura		
d) Pajisje për parandalimin e lëvizjes së pakontrolluar të kabinës gjatë ngritjes		
e) Pajisjet për kufizimin e mbi-shpejtësisë		
f) Ndriçimi emergjent		
g) Amortizatorët		
h) Çelësat e sigurisë		
2. Gjendja e përgjithshme dhe funksionimi i:		
a) Kabina, kolona dhe vendi i agregatit		
b) Dymt në kabinë dhe dymt në sheshpushim		
c) Kavot metalike dhe kavo tërheqëse		
d) Shinat udhëzuese		
e) Sistemi i frenimit		
f) Komponentë të instalimit elektrik		
g) Agregati ngritës		
h) Ventilimi (në kabinë, kolonë dhe në vendin e agregatit)		

i) Pajisjet e kontrollit		
3. Inspektimi teknik i kabinës dhe kolonës:		
a) Natyra dhe tipi i mureve të kolonës		
b) Kabina dhe veshja e brendshme e kabinës dhe kontrolli i përmasave		
c) Udhëzuesit dhe varja e kabinës dhe kundërpesha		
d) Kabina dhe udhëzuesit e kundërpeshës		
e) Kavot metalike, transmisioni kremalier-pinjon, zinxhirët		
f) Kabllot elektrike poshtë kabinës		
g) Kontrolli i dyerve në sheshpushim dhe dyerve në kabinë		
h) Pajisja bllokuese e derës dhe çelësi i tij		
i) Dera e emergjencës		
j) Mekanizmi i kontrollit për inspektimin e tavanit të kabinës		
k) Sistemi i komunikimit emergjent		
l) Pulexhot		
m) Tavani i kabinës		
n) Hapësira e kolonës		
o) Hapësira ndërmjet kabinës dhe kundërpeshës dhe kolonës së ashensorit		
p) Kundërpesha		
4. Përshkrime të tjera		

Siguria e ngarkesës punuese maksimale si objekt i riparimeve (nëse ka): _____

Vërejtje të tjera: _____

Data e inspektimit tjetër periodik: _____

14.2 Seksioni B

Raporti plotësohet vetëm në rastin e një dëmtimi të pashmangshëm të rëndë personal sipas nënplikës 7.10

Një kopje e plotësuar e seksionit B dërgohet në ministrinë përgjegjëse për tregtinë dhe Strukturën Përgjegjëse brenda 48 orëve.

Përshkrimi i riskut ekzistues ose të pashmangshëm që mund të rezultojë me dëmtim të rëndë të personit _____

Riparimet ose modifikimet e nevojshme: _____

Afati kohor i përcaktuar për përfundimin e punimeve të cilat mundësojnë që ashensori të jetë përsëri në përdorim: _____

14.3 Seksioni C – Deklarimi

Unë/ne deklaroj që.....unë/ne kemi kryer një inspektim periodik parandalues mbi këtë ashensor dhe që përfundimisht raporti është në përputhje me rezultatin.

Organi i miratuar nr.....

Adresa

Firma/t

Data

15. Lista e standardeve të harmonizuara që kanë karakter referues për prezumimin e sigurisë të ashensorëve ekzistues dhe të rinj

S SH EN 81-80:2003

Rregulla të sigurisë për ndërtimin dhe instalimin e ashensorëve - Ashensorët ekzistues - Pjesa 80: Rregullat për përmirësimin e sigurisë për ashensorët ekzistues për pasagjerë dhe mallrat e pasagjerëve

S SH EN 13015:2001

Mirëmbajtja e ashensorëve dhe e shkallëve lëvizëse – Rregullat për instruksionet e mirëmbajtjes

S SH EN 81-58:2003

Rregulla të sigurisë për ndërtimin dhe instalimin e ashensorëve – Kontrolli dhe provat – Pjesa 58: Prova e zjarr qëndrueshmërisë së dyerve në sheshpushim.